



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi

Mbledhja nr. 17

Prishtinë, më 12 majit 2010, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Në mbledhje morën pjesë: Bahri Hyseni - kryetar, Adem Hajdaraj, Bajram Kosumi, Ramadan Gashi, Gani Geci, Ibrahim Makolli, Armend Zemaj, Selvi Halimi, Radmila Vujoviq dhe Kolë Berisha.

Mungoi: Mufera Şinik

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Bajram Ukaj, Rexhep Gashi, Sokol Zogaj dhe Islam Musa – ekspertë të angazhuar nga Komisioni, Xhevat Azemi – AKP, Scot Bown - AKP, Fetije Halilaj – AKP, Isuf Zejna – KDI, Violeta Rexha – EULEX, Sanije Berisha – OSBE, Zenel H. Kelmendi – ZKM, Jeton Oruqi – ZKM, Lumnije Murati – ZPRK, Albulena Ademi dhe Dafina Bardhi – praktikante.

Nga Stafi i Komisionit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni, Sulltane Gashi dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 4 majit 2010,
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2009,
4. Shqyrtimi i Propozimamendamenteve i grupit të punës për shqyrtimin e Projektligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale,
5. Shqyrtimi i Propozimamendamenteve në Projektligjin për financimin e partive politike dhe në Projektligjin për mbrojtjen nga dhuna në familje,
6. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari propozoi që të fillohet me pikën e katër të rendit të ditës për shkak të prezencës së ekspertëve, që janë ftuar lidhur me P/Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale, në mënyrë që të lirohen me kohë.

Rendi ditës u miratua me ndryshime

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 4 majit 2010

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 4 maj 2010, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Propozimamendamenteve i grupit të punës për shqyrtimin e Projektligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale

Kryetari paraqiti për shqyrtim Propozimamendamentet e grupit punues në P/Ligj për ekzekutimin e sanksioneve penale. Ftoi Armend Zemaj ta paraqesë arsyetimin e amendamenteve në emër të grupit punues.

Armend Zemaj - Falënderoi ekspertet për angazhimin dhe korrektësinë në shqyrtimin e këtij P/ Ligji. Grupi punues ka mbajtur takime të rregullta sipas dinamikës së përcaktuar në bashkëpunim me ekspertët. Në vazhdim theksoi se kemi paraparë dy pjesë të reja që të futen në këtë P/Ligj, e që është ekzekutimi i masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim, si dhe ekzekutimi i dënimit me burgim për kundërvajtje të propozuara nga ekspertët e angazhuar nga Komisioni, Bajram Ukaj dhe Regjep Gashi. Këto dy amendamente janë përmbajtjesore, kurse të tjerat ma tepër janë përshtatje dhe disa formulime, gjë që kemi bërë përpjekje të mos bëjmë shumë amendamente.

Ishin të diskutueshëm amendamentet 34 dhe 37, ku diskutuan Armend Zemaj, i cili dha sqarim në emër të grupit punues. Diskutuan edhe Gani Geci, Ramadan Gashi, Ibrahim Makolli, Selvije Halimi, Bajram Kosumi dhe Adem Hajdaraj.

Sqarime shtesë dhanë edhe ekspertët e angazhuar nga Komisioni.

Kryetari konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

PËRFUNDIM

Miratohen amendamentet e propozuara nga grupi punues në P/Ligj për ekzekutimin e sanksioneve penale, të njëjtat procedohen për shqyrtim të mëtejme.

4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2009

Kryetari - Përsëritet përfaqësuesit e AKP – së dhe theksoi se Raporti është sjellë brenda afatit të paraparë ligjor. I njoftoi se AKP- ja deri me tash ka ushtruar funksionin në përputhje me disa rregullore. Kurse në vitet e kaluar është aprovuar ligji dhe tani kjo agjenci vepron në pajtim me ligjin në fuqi. Në Raport janë përfshirë edhe biografitë e anëtarëve të kësaj Agjencie dhe kjo është me rëndësi për anëtarët e Komisionit. Raporti është i detajuar dhe flet për numrin e kërkesave duke i specifikuar edhe komunitatet e llojet e kërkesave.

Scot Bown - Drejtor- AKP- së, në fjalën e tij u pajtua me informacionet që paraqiti kryetari i Komisionit, i cili në vazhdim paraqiti një kronologji të fushëveprimit të këtij institucioni që vepron në pajtim me ligjin, 03/L-079, i cili është shpallur nga Kuvendi i Kosovës. Në vazhdim foli në hollësi për mandatin e AKP- së, kërkesat pronësore, të drejtën e shfrytëzimit dhe çështje të tjera që bien në fushëveprimin e AKP- së.

Gani Geci - Duke u ndërlidhur me parafolësin tha se ne, si shoqëri kosovare, kemi disa probleme specifike. Fjala është për pronat banesore, ka persona që gjatë viteve 1989 – 1999, janë larguar me dhunë nga banesat, kurse dokumentacionet u janë dhënë dikujt tjetër, kurse vazhdojnë procedurat gjyqësore duke mos ju njohur e drejta në pronë edhe pse ata kanë qenë pronar të atyre pronave e që me dhunë u janë marrë. Pyeti a keni pasur ndonjë kërkesë të kësaj natyre dhe çfarë keni ndërmarrë ju?

Xhevat Azemi, zëvendësdrejtor AKP- së - Theksoi se është rasti i parë që ne zyrtarisht raportojmë para Kuvendit. Kjo sipas tij është shumë me rëndësi, sepse shumë herë nga personat e caktuar ka dilema se cili është funksioni i Agjencisë, në këtë kontekst jemi të interesuar për transparencë. Në pyetjen e shtruar nga parafolësit u përgjigj që mandati kryesor i Agjencisë është zgjedhja e konteksteve për pronën bujqësore dhe komerciale, e cila është themeluar në vitin 2006. Mirëpo kjo nuk e përjashton edhe zgjedhjen e kontesteve për prona banesore. Kjo drejtori ka trashëguar një pjesë të mandatit nga drejtoria për çështje pronësore banesore që njihet si *Habitat*. Në vazhdim dha informata rreth kërkesave të parashtruara dhe çështjet e tjera në funksion të zgjedhjes së tyre.

Kryetari konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

R e k o m a n d i m

- I. Të shqyrtohet dhe të miratohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës Raporti vjetor i Agjencisë Kosovare të Pronave për vitin 2009,
- II. Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të bëjë propozimin për emërimin e anëtarëve në bazë të ligjit,
- III. Të shtohet angazhimi, jo vetëm nga Agjencia, por nga të gjitha institucionet që të funksionalizohen zyrtar jashtë Kosovës, veçmas në Serbi.

5. Shqyrtimi i Propozimamendamenteve në Projektligjin për financimin e partive politike dhe në Projektligjin për mbrojtjen nga dhuna në familje

Kryetari paraqiti Propozimamendamentet e këtyre projektligjeve që të konstatohet baza juridike: Projektligjin për financimin e partive politike dhe në Projektligjin për mbrojtjen nga dhuna në familje.

Ishte i diskutueshëm amendamenti 6 në Projektligjin për financimin e partive politike, si dhe amendamentet 1 dhe 4 në Projektligjin për mbrojtjen nga dhuna në familje. Lidhur me amendamentet 1 dhe 4 në P/L, Projektligjin për mbrojtjen nga dhuna në familje, Komisioni sugjeron që të rishikohen, si dhe është qëndrim i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi që fjala “ Shqiptimin” është më adekuate se sa fjala “ caktimin”.

Lidhur me këto propozimamendamente diskutuan: Gani Geci, Ramadan Gashi, Selvije Halimi, Adem Hajdaraj dhe Armend Zemaj.

Kryetari konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

PËRFUNDIM

Komisioni shqyrtoi Propozimamendamentet në Projektligjin për financimin e partive politike dhe në Projektligjin për mbrojtjen nga dhuna në familje,

Komisioni vlerëson se amendamentet e propozuara kanë bazë juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

6. Të ndryshme

Lidhur me këtë pikë nuk kishte diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 16:00

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni